



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 27.02.2025

PËR

REFUZIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 9 DHE 11 KATE MBI TOKË, ME 2 KATE
PARKIM NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “ABEDIN REXHA”,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 10/2 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvilluesit shoqërisë “ADMC International” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimesh 9 dhe 11 kate mbi tokë, me 2 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Abedin Rexha”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “ADMC Internacional” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.
4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/05 2025